


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE TIRANË
NR. REP 55
NR. KOL 17



KONTRATË PËR SHITJE KOUTASH

Sot më datë 3.2.2006 përpara meje Noteres të Dhomës së Notereve Tiranë Luena Tolica u paraqitën personalisht:

SHITESI: ZNJ. Ines Ajdini, shtetase shqiptare, lindur në Tirane me 1973, banuese në Tiranë, Rr. Hil Mosi nr. 3, pas. nr. Z 0782484;

dhe

BLERESJA: ZNJ. ALBA GINA, shtetase shqiptare, lindur në Lushnje, më 1977, banuese ne Tirane, Rr. Dervish Hima, nr. 1, ap._ pas. nr. Z 1019362.

të dyja madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar për identitetin e të cilave ne noterja u sigurova pasi verifikova dokumentat përkatës të indentifikimit të cilat më deklaruan se kërkojnë të lidhin kontratën e mëposhtme të shitjes se kuotave te shoqerise Agia Sh.p.k.

Kushte Paraprake:

- Shitësja zotëron, në cilësinë e pronarit, 30% (tridhjetë) përqind të kuotave të shoqerise "AGIA 2004" Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të krijuar sipas të drejtës shqiptare, e regjistruar ne regjistrin tregtar me nr. 31515, date 27.4.2004 ("Shoqëria");
- Shitësja deshiron t'i shese Blerëses te gjithë pjesmarrien e saj ne kete shoqeri te barabarte me 30% (tridhjetë përqind) të kuotave të Shoqërisë dhe Blerësja është dakort ti blejë ato;
- Vendimi për shitblerjen e kuotave është miratuar nga Asambleja e Ortakëve datë 3.2.2006.

Meqenëse ekzistojnë kushtet paraprake të mësipërme:

NENI 1 – KUSHTET PARAPRAKE

Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

NENI 2 –OBJEKTI

- 2.1. Shitësja i transferon Blerëses, dhe Blerësja pranon te bleje 30% (tridhjetë përqind) të te kuotave te kapitalit të Shoqërisë, te barabarta me 40 kuota të lirë nga çdo lloj detyrimi apo barre.
- 2.2. Blerësja i paguan Shitëses në këmbim të titullit të pronësisë të kuotës prej 30% të Shoqërisë Cmimin prej 40,000 (dyzetemije) lekë. Kjo shumë i paguhet Shitësit

menjëherë me nënshkrimin e kontratës. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësja behet ortak e vetme e shoqërisë Agia 2004 Sh.p.k.

NENI 3 – TË NDRYSHME

- 3.1. **Dividendi.** Shitesi deklaron se heq dore nga çdo shume për dividend mbi pjesën e kuotës së tij, të maturuar deri në momentin e realizimit të kësaj kontrate shitjeje dhe të pashpërndare.
- 3.2. **Te Drejta mbi Kuotat.** Blerësi me nënshkrimin e kësaj kontrate fiton të gjitha të drejtat mbi kuotat e merr përsiper të gjitha detyrimet mbi to. Duke qenë se Blerësi është ortak i shoqërisë e njëkohësisht administratore e saj, ajo e njëj gjendjen aktuale shoqërisë dhe merr përsiper edhe riskun e lidhur me sendin që po blen.
- 3.3. **Njoftimet.** Të gjitha njoftimet, ose kërkesat e tjera të kërkuara për t'iu bërë njërës prej palëve do të jenë më shkrim dhe do të dërgohen në adresën e paraqitur më sipër në këtë Kontratë.
- 3.4. **Shpenzimet dhe Taksat.** Të gjitha kostot dhe shpenzimet ligjore, kontabile dhe tatimore të lindura në lidhje me këtë Kontratë dhe transaksionin e parashikuar aty do të paguhën nga Blerësi.
- 3.5. **Marrëveshja e plotë, ndryshimet.** Kjo Kontratë përbën të tërë marrëveshjen e lidhur midis palëve në lidhje me këtë çështje dhe mbizotëron ndaj të gjitha marrëveshjeve të mëparshme. Kjo Kontratë, ose ndonjë dispozitë e saj mund të ndryshohet ose hiqet dorë prej saj vetëm me shkrim.
- 3.6. **Origjinalet.** Kjo kontratë nënshkruhet në katër ekzemplarë në shqip.
- 3.7. **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve.** Të gjitha mosmarrëveshjet midis palëve të lindura prej ose në lidhje me interpretimin dhe ose nënshkrimin e kësaj Kontrate, të cilat nuk do të arrihet të zgjidhen me mirkuptim prej vetë palëve, do t'i besohen për tu zgjidhur në mënyrë përfundimtare dhe eskluzeve prej Gjykatës së Rrethit Tiranë.
- 3.8. **E Drejta e Zbatuar.** Kjo Kontratë dhe të drejtat e detyrimet e palëve do të rregullohen dhe zbatohen sipas të drejtës shqiptare.

NENI 4 – FORCë MADHORE

- 4.1. Për qëllim të kësaj kontrate, Forcë Madhore do të thotë, pa u kufizuar vetëm në këto, çdo urdhër, rregullim ose udhëzim të Qeverisë, i nxjerrë në formën e një ligji ose në çdo formë tjetër, apo çdo sanksion i një natyre kombëtare ose ndërkombëtare, apo çdo vepër e Zotit, revolta, ngritje, trazira civile, lufta (qoftë e deklaruar apo e padeklaruar), veprime apo kërcënime terroristësh ose grupe guerilësh apo individësh, greva apo shqetësime të tjera pune, zjarre, përmbytje, tërmete, apo çdo shkak tjetër që vjen jo si pasojë e fajit apo neglizhencës së palëve, apo secilës prej tyre, qoftë apo jo e njëjtë me paraprirëset, duke marrë parasysh që çdo shkak i tillë nuk varet nga palët që preken.

4.2. Mospërbushja apo përbushja me vonesë nga palët, apo secila prej tyre, të çdo detyrimi sipas kësaj kontrate do të justifikohet nëse dhe në masën që një mospërbushje apo përbushje me vonesë shkaktohet nga një Forcë Madhore. Periudha e një mospërbushje apo përbushje me vonesë, së bashku me periudhën që do të jetë e nevojshme për të vënë në vend çdo dëm të shkaktuar gjatë kësaj vonese, do t'i shtohet kohës së dhënë në këtë kontratë për përbushjen e detyrimeve të tilla që varen nga to dhe gjatë kohës së kësaj Marrëveshje.

4.3. Secila palë që pretendon se ekziston Forcë Madhore duhet të njoftojë palën tjetër sa më shpejt të jetë e mundur pas ndodhjes së ngjarjes.

* * *

Këtë kontratë pasi e përpilova ua lexova me zë të lartë të pranishmëve të cilët me deklaruan se e gjejnë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe e nënshkruan përpara meje noterit.

SHITËSJA:

BLERËSJA:

Ines Ajdini Ines Ajdini
Znj. Ines Ajdini


Alba Gina
Znj. Alba Gina

Data: ____ Shkurt 2006

Data: ____ Shkurt 2006

NOTER

Luena Tolica



LUENA TOLICA
DHOMA E NOTEREVE
068 20 70 787

[Signature]